



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:236426
Datë: 29.01.2025
Numri i dokumentit: 06774293

Rev.nr.567/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Muhamet Rexha dhe Milena Gjeriq, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve: I. K., A. K., A. K. dhe T. Rr., të cilët i përfaqëson Fatbardh Makolli, avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurës: K. e S. e "...", me seli në P., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar M. B., sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësve të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.717/2022, të datës 17.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 27.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË i palejuar revizioni i paditësve: I. K., A.K, A. K. dhe T. Rr., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.717/2022, të datës 17.09.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1277/2019, të datës 11.11.2021, të korrigjuar me aktvendimin C.nr.1277/19, të datës 02.12.2021, është vendosur: Pjesërisht aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve I., A., A.K. dhe T. Rr., të cilët i përfaqëson av. F. M. nga P., rr. ..., kundër të paditurës K. e S. "...", baza juridike: Kompensim dëmi. I. Detyrohet e paditura K. e S. "...", me seli në P., që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material për veturën e paditësit t'ia kompensoj shumën në lartësi prej 1,643.1 €. II. Detyrohet e paditura që paditësve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial t'ia kompensoj dëmet dhe atë: - Për I. K.: në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material: për dhimbje fizike, 3,000 €; për frikë, 2,000 €; për ndihmën e huaj 400 €; për ushqim të përforcuar 400 €; zvogëlim të aktivitetit jetësor 3,000 €; për shpenzime të shërimit 600 €; për rehabilitim fizioterapeutik dhe klimatik 600 €. Gjithsej për lëndime 10,000 €. - Për A. K. : Në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial: Për dhimbje fizike, 1.000 €; për frikë 800 €; për shpenzime të shërimit 1.000 €; për rehabilitim fizioterapeutik dhe klimatik, 300 €. Gjithsej për lëndime 2.400 €. - Për A. K.: Në emër të kompensimit të dëmit material dhe

jomaterial: Për dhimbje fizike 1.000 €; për frikë 800; për shpenzime të shërimit 1,000 €; për rehabilitim fizioterapeutik dhe klimatik 300 €. Gjithsej për lëndime 2,400 €. - Për T. Rr.: Në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial: Për dhimbje fizike 1.000 €; për frikë 800 €; për shpenzime të shërimit 300 €; për rehabilitim fizioterapeutik dhe klimatik 300 €. Gjithsej për lëndime 2.400 €. III. Detyrohet e paditura K. e S. "...", P., që të autorizuarit të paditësve F.M., në emër të shpenzimeve procedurale të ia paguaj shumën prej 3,032 €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit. IV. Detyrohet e paditura K. e S. "...", P., që shumat e aprovuara nga pika I dhe II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi ti paguaj me kamatë ligjore prej 8%, nga dita kur është përpiluar ekspertiza mjekësore me datë 27.03.2021, e gjer në pagesën definitive, e të gjitha këto ti paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. V. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit përtej shumës së aprovuar si në pikën I dhe II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi si jo e bazuar.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës me aktgjykimin Ac.nr.717/2022, të datës 17.09.2024, ka vendosur: I. Pjesërisht refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës K. e S. "...", sh.a., me seli në P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1277/2019 i datës 11.11.2021, në pikën I dhe II, sa i përket dëmit jomaterial për paditësit: - I. K.: për dhimbjet fizike, për frikë, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor si dhe dëmin material, për ushqim të përforcuar, për ndihmë dhe kujdesin e personit të tretë, për paditësit: - A. K., A. K., T. Rr., për dëmin jomaterial për dhimbjet fizike, për frikë si dhe pika III dhe IV, Vërtetohet II. Pjesërisht aprovohet si e themeltë ankesa të paditurës K. e S. "...", sh.a., me seli në P., Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1277/2019 i datës 11.11.2021, në pikën II, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadiës, për kompensimin e dëmit material: në emër të rehabilitimit fizioterapeutik-klimatik dhe shpenzimeve të mjekimit dhe gjykohet si në vijim: Detyrohet e paditura K. e S. "...", sh.a., me seli në P., që në emër të kompensimit të dëmit material për rehabilitimin fizioterapeutik-klimatik ti paguaj paditësit I. K., në shumën prej 120 €, për shpenzimet e shërimit, për paditësit I.K., A. K., A. K., dhe T. Rr., shumën prej nga 10 €, për secilin paditës, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësve, përtej shumave të gjykuar për këto kategori të dëmit e deri në shumat e kërkuar, si dhe për rehabilitimin fizioterapeutik - klimatik për paditësit A. K., A. K. dhe T. Rr., refuzohen në tërësi si të pabazuar. III. Pika V, e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1277/2019 i datës 11.11.2021, mbetet e pashqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësit në afatin ligjor kanë paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të pranoj revizionin, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë ta ndryshoj dhe ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, sikurse në precizimin e kërkesëpadiës të datës 02.08.2021.

Përgjigje në revizion nuk ka pasur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësve është i palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, më datë 17.10.2019, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit, me të cilën kanë

kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial t'ia paguajë shumën e kërkuar më saktësisht si në parashtrësën për precizimin e padisë të datës 29.07.2021.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësve kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin C.nr.1277/19 të datës 11.11.2021, i korrigjuar sipas aktvendimit C.nr.1277/19, të datës 02.12.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.717/2022, të datës 17.09.2024, ka vendosur që të aprovojë pjesërisht ankesën e të paditurit, ndërsa aktgjykimin e atakuar e ka ndryshuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë paditësi ka paraqitur revizion, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike - kontestimore fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e revizionit dhe konstatoi se në këtë rast revizioni është i palejueshëm, për arsye se:

Me nenin 218, të LPK-së, dhe nenin 11, të Ligjit Nr. 04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, me të cilin është riformuluar neni 218 i ligjit bazik, përcaktohet se: “1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hudhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore. 2. Revizioni është i palejueshëm nëse: a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit; b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin; c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij; d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet”.

Me nenin 211 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk kalon 3,000 € ”, ndërsa në paragrafin 4, të këtij neni përcaktohen përjashtimet, si: “ Përjashtimisht edhe kur bëhet fjalë për kërkesëpadinë nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni, revizioni gjithmonë është i lejuar: a) në kontestet për ushqim, b) në kontestet për shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur për shkak të vdekjes së dhënies së ushqimit dhe c) ndaj kontestet ndaj marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuari kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se revizioni nuk lejohet kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.717/2022, të datës 17.09.2024, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së revizionit e kushtëzuar me vlerën e kontestit e cila duhet të jetë mbi 3,000 €, për të qenë i lejuar revizioni, dhe situatës kur revizioni lejohet pavarësisht vlerës së kontestit sipas kriterit përjashtues për natyrën e çështjes kontestuese. Në këtë rast paditësit janë pajtuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.1277/2019, të datës 11.11.2021 dhe ndaj të njëjtit nuk kanë ushtruar ankesë. Ndërsa gjykata e shkallës së dytë duke vepruar sipas ankesës së të paditurës, të njëjtën e ka aprovuar pjesërisht dhe vetëm sa i përket kompensimit të dëmit material: në emër të rehabilitimit

fizioterapeutik - klimatik dhe shpenzimeve të mjekimit duke e gjykuar ashtu që: në emër të kompensimit të dëmit material për rehabilitimin fizioterapeutik – klimatik, për paditësin I. K., shumën prej 120 €, për shpenzimet e shërimit, për paditësit I. K., A. K., A. K., dhe T. Rr., shumën prej nga 10 €, për secilin paditës.

Duke pas parasysh se shumata e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, lidhur me kompensimin e dëmit material ka qenë ashtu që: për paditësin I. K., në emër të rehabilitimit fizioterapeutik - klimatik dhe shpenzimeve të mjekimit, nga 600 €, në total shumën prej 1,200 €, për paditësin A. K., në emër të rehabilitimit fizioterapeutik - klimatik dhe shpenzimeve të mjekimit, nga 300 €, në total shumën prej 600 €, për paditësin A. K., në emër të rehabilitimit fizioterapeutik - klimatik dhe shpenzimeve të mjekimit, nga 300 €, në total shumën prej 600 €, dhe për paditësin T.Rr., në emër të rehabilitimit fizioterapeutik - klimatik dhe shpenzimeve të mjekimit, nga 300 €, në total shumën prej 600 €, e që rezulton fakti se pjesa e ndryshuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë për secilin paditës nuk kalon shumën prej 3,000 €.

Përveç të cekurave në këtë çështje juridike-kontestimore kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqës të thjeshtë, ku pozita procedurale e një bashkëndërgjyqësi nuk varet nga pozita procedurale të bashkëndërgjysëve tjerë. Në bazë të nenit 268 të LPK-së, çdo njeri nga këta është i pavarur në gjykim dhe se vlera e kontestit merret veç e veç për çdo njeri prej tyre.

Nga kjo rezulton se pjesa e ndryshuar e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, nga ana e gjykatës së shkallës së dytë në raport me shumata e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë për secilin paditës nuk e kalon shumën prej 3,000 €, ndërsa në pjesën në të cilën është refuzuar ankesa e të paditurës, paditësit nuk kanë të drejtë të paraqesin revizion sepse në momentin e mos parashtrimit të ankesës në gjykatën e shkallës së dytë, rezulton se janë pajtuar me shumata e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë sa i përket kësaj pjese, dhe tani nuk kanë të drejtën e atakimit të kësaj pjese me revizion dhe po ashtu natyra e kontestit nuk përbën përjashtim për lejueshmërinë e revizionit (përjashtimet pavarësisht vlerës), prandaj në këtë rast për shkak të vlerës së kontestit, revizioni është i palejuar.

Andaj më qenë se gjykata e shkallës së parë nuk e ka hedh revizionin e të paditurit ashtu siç përcaktohet me nenin 218 të LK-së, atëherë Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 221 të LPK-së, vendosi që ta hedhë poshtë si të palejueshëm revizionin.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 221 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr. 567/24, më datë 27.01.2025.

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi